



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 03.07.2013
Nr. 0204-869

PËR: Pal Lekaj, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Xhavit Alijaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS, 01 Nr. 011 - 3286, Pranuar me datë, 01.07.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 011 - 3286 të miratuar me datë 27.06.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01.Nr. 011 - 3286, aprovohet kërkesa për lirim nga taksa për të gjitha bizneset që gjenden në rrugën "Ismail Qemajli" në "Çarshinë e Madhe", ku janë duke u kryer punimet në infrastrukturë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 03.07.2013
br. 0204-869

Za: Pal Lekaj, Gradonačelnik opštine Đakovica
Xhavit Alijaj, Predsedavajući Skupštine opštine Đakovica

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Đakovica , 01 br. 011 - 3286, Priljeno dana , 01.07.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 011 - 3286 odobreno dana 27.06.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .


Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01.br. 011 - 3286, usvaja se zahtev za oslobodjenje sa poreza za sve biznise puta "Ismail Qemajli" u "Çarshinë e Madhe", gde se vrše radovi u infrastrukturi.

Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____ /2013
Dt. 27.06.2013

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe, nenin 17 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.06.2013, pas diskutimeve lidhur më pikën e III-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i propozimit për lirim nga taksa në firmë për vitin 2013, të Bizneseve që gjenden në rrugën "Ismail Qemajli" në "Çarshinë e Madhe", ku janë duke u kryer punimet në infrastrukturë, e miratoi këtë:

V e n d i m

- I. Aprovohet kërkesa për lirim nga taksa në firmë për të gjitha bizneset që gjenden në rrugën "Ismail Qemajli" në "Çarshinë e Madhe", ku janë duke u kryer punimet në infrastrukturë.
- II. Lirimi nga obligimi për pagesën e taksës vien për vitin kalendarik 2013 .
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe të nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit .
- IV. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës,
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
 - Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Xhavit Alijaj